



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Prishtinë, 05 dhjetor 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në bazë të nenit 115 paragrafit 1, nenit 117 paragrafi 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), që është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, në mbledhjen e mbajtur me datën 22 nëntor 2012, dhe duke u bazuar në analizat dhe praktikën e mira që nga zgjedhjet e vitit 2000, ka miratuar Rregullën Nr. 01/2012 **Për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave.**

Kjo komunikatë ka për qëllim informimin e subjekteve politike dhe opinionin publik për miratimin e Rregullës Nr. 01/2012 “**Për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave**” me të cilën PZAP-i, mund të shqiptoj gjoba dhe sanksione ndaj Subjekteve Politike dhe palëve tjera që janë pjesëmarrëse gjatë procesit zgjedhor.

Rregullorja është e publikuar në Faqen Zyrtare të Institucionit të PZAP-it në gjuhën shqipe dhe serbe

Me respekt,